



# KODI ETIK

---

Kodi Etik i Platformës CiviKos

04/04/2014

## **PREAMBULE**

## **Platforma CiviKos**

Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe avancuar një mjedis të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës.

### **Misioni**

Misioni i CiviKos është krijimi i një mjedisi formal të bashkëpunimit midis sektorit të shoqërisë civile me institucionet shtetërore në Kosovë.

### **Qëllimet**

Për realizimin e misionit të vet, CiviKos punon në arritjen e qëllimeve në vijim:

Formalizimin e kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit midis sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës; dhe

Koordinimin e aktiviteteve të organizatave anëtare të cilat synojnë krijimin apo avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës.

## PARIMET UDHËHEQËSE

CiviKos dhe organizatat anëtare zotohen se do t'i shërbejë misionit të platformës dhe misioneve të tyre individuale duke iu përmbajtur këtyre parimeve udhëheqëse të punës:

**Përgjegjësia dhe shërbimi publik** – CiviKos është platformë e organizatave të dedikuara për zhvillim, demokraci, paqë dhe drejtësi dhe në këtë drejtim kërkohet kontributi i secilit anëtar. Organizatat anëtare të CiviKos mbajnë përgjegjësi të lartë publike në punën e tyre dhe i shërbejnë me përkushtim misioneve dhe anëtarëve të tyre,

**Bashkëpunimi efektiv** – arritja e synimeve të përbashkëta kërkon bashkëpunim të ngushtë në mes të të gjithë anëtarëve të CiviKos, pa dallime të asnjë lloji natyre. Për më tepër, bashkëpunimi me organizatat dhe rrjetet e tjera të shoqërisë civile, institucionet shtetërore, median dhe sektorë e komunitete të tjera të shoqërisë janë në themelin e punës dhe angazhimit të CiviKos,

**Të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta** – CiviKos dhe të gjitha organizatat anëtare të platformës punojnë mbi parimin e respektimit të të gjitha të drejtave themelore të njeriut, bazuar mbi premisën se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet. CiviKos dhe organizatat anëtare të platformës i kushtojnë kujdes të veçantë vlerave morale, traditave, kulturës dhe fesë së të gjitha komuniteteve.

**Transparenca dhe Llogaridhënia** – dy parimet themelore të punës së CiviKos dhe organizatave anëtare të platformës në raport me palët e treta dhe anëtarët e tyre janë transparenca dhe llogaridhënia. CiviKos është platformë e organizatave që zotohen për të bërë publike informatat relevante mbi financat, strukturën qeverisëse, aktivitetet, pasuritë dhe të tjera për publikun.

**Vërtetësia dhe ligjshmëria** – CiviKos dhe të gjitha organizatat anëtare të platformës veprojnë me sinqeritet në veprimtaritë e tyre në raport me donatorët, përfituesit e projekteve, stafin, anëtarët, organizatat partnere, institucionet shtetërore dhe publikun në përgjithësi, duke iu përkushtuar pa kompromise respektimit të legjislacionit në fuqi.

## **KODI ETIK**

Kuvendi i Anëtarëve të Platformës CiviKos, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.04.2014, në bazë të nenit 6.3 të Statutit të Platformës CiviKos dhe me shumicë prej 2/3 të votave të anëtarëve prezent, miratoi këtë Kod Etik të Platformës CiviKos.

### **Qëllimi**

Kodi Etik (këtu e tutje, "Kodi") ka për qëllim të sigurojë bashkëpunim dhe raporte të ndërsjella në mes të anëtarëve të Platformës CiviKos të bazuara në parime etike dhe profesionale dhe në mirëbesim reciprok.

Kodi pasqyron përkushtimin e Platformës CiviKos dhe anëtarëve të saj ndaj parimeve etike në aktivitetet e tyre për të përmbushur misionin e Platformës.

Respektimi, promovimi dhe zbatimi i Kodit nga të gjithë anëtarët është detyrim parimor dhe organizatat anëtare marrin për obligim që të ruajnë integritetin e këtij kodi.

### **Fushëveprimi**

Ky kod vlen në raportet ndërmjet organizatave anëtare të CiviKos-it, në raportet e organizatave anëtare me CiviKos-in dhe në raportet e organizatave anëtare me organizata jo-anëtare dhe palë të treta.

Kodi nuk vlenë në raportet e brendshme ndërmjet stafit të sekretariatit të CiviKos-it dhe në raportet e brendshme të cilat i takojnë qeverisjes së brendshme dhe autonomisë së organizatave anëtare.

Asgjë nga përmbajtja e këtij Kodi nuk duhet kuptuar si ndërhyrje apo tendencë për ndërhyrje në autonominë dhe pavarësinë e organizatave anëtare në përcaktimin dhe zbatimin e politikave apo praktikave të caktuara të qeverisjes së brendshme të tyre, për aq sa ato politika apo praktika nuk bien ndesh me parimet udhëheqëse të CiviKos-it dhe ose të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parapara me ligje vendore dhe ndërkombëtare.

### **Natyra e Kodit**

Duke marrë parasysh burimet e kufizuara të organizatave të shoqërisë civile në raport me përgatitjen dhe zbatimin e dispozitave të ndryshme të këtij Kodi, si dhe duke theksuar qëllimin e avancimit të normave profesionale dhe etike të shoqërisë civile në Kosovë, ky Kod nuk do të përmbajë dispozita dhe mekanizma sanksionues për një periudhë tre (3) vjeçare nga hyrja në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe tre (3) vjeçare, CiviKos do të asistojë dhe do të bashkërendojë përpjekjet e organizatave anëtare dhe palëve tjera për të ngritur kapacitetet e organizatave anëtare në të kuptuarit e drejtë, harmonizimin e dokumenteve, politikave dhe praktikave në atë mënyrë që të jenë në përputhje me këtë kod.

## **PARIMET E PËRGJITHSHME ETIKE DHE PROFESIONALE**

### **Integriteti Profesional**

Organizatat anëtare të CiviKos-it zotohen se do të veprojnë duke respektuar parimet më të larta të integritetit profesional, duke u angazhuar për një mision të ligjshëm dhe në të mirë të anëtarëve dhe/ose publikut; respektimin e ligjit; respektimin e diversitetit shoqëror dhe parimeve bazë të demokracisë; respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; respektimin e procedurave dhe politikave të brendshme të vendimmarrjes; respektimin dhe promovimin e integritetit të këtij Kodi.

### **Angazhimi jo-për-përfitim**

Organizatat anëtare të CiviKos-it janë themeluar, ekzistojnë dhe do të vazhdojnë të veprojnë ekskluzivisht dhe vetëm për qëllime jo-për-përfitim, ashtu siç është definuar në legjislacionin të aplikueshëm për liri të asociimit.

### **Paanshmëria Politike dhe Pavarësia Operacionale**

Organizatat anëtare të CiviKos-it janë të paanshme politikisht. Ato nuk janë pjesë apo nuk kontrollohen ligjërisht apo faktikisht nga qeveria ose ndonjë institucion tjetër shtetëror; parti të politike; grupet e caktuara të interesit ekonomik, politik, apo interesi tjetër që bien ndesh me parimin jo-për-përfitim dhe/ose me parimet udhëheqëse të CiviKos, në mënyrë që të sigurojnë pavarësinë e plotë të veprimit dhe shprehjes së qëndrimeve publike karshi të gjitha çështjeve të interesit publik.

Organizatat anëtare janë autonome në marrëdhëniet e tyre të brendshme; në përcaktimin e procedurave, politikave dhe praktikave të qeverisjes dhe përzgjedhjes së stafit të tyre të brendshëm.

### **Besimi Publik**

Organizatat anëtare të CiviKos-it angazhohen maksimalisht që të gëzojnë besim publik në komunitetin, grupet shoqërore, komunën, regjionin apo shtetin në të cilin veprojnë.

Për të siguruar dhe mirëmbajtur një nivel të kënaqshëm të besimit publik, CiviKos dhe të gjitha organizatat anëtare të platformës angazhohen maksimalisht për transparencë dhe

llogaridhënie publike, duke u udhëhequr nga parimi i sinqeritetit gjatë dhënies së informacionit për publikun.

### **Vullnetarizmi**

Organizatat anëtare të CiviKos-it veprojnë në bazë të parimit të vullnetarizmit si formë e bashkimit të një grupi individësh për të shtyrë përpara një interes apo shqetësim publik i cili prekë një grup shoqëror të caktuar apo shoqërinë në tërësi.

Organizatat anëtare të CiviKos-it, angazhohen, krijojnë kushte të nevojshme, si dhe inkurajojnë përfshirjen e sa më shumë vullnetarëve në punën e tyre, si mënyrë e drejtpërdrejtë e angazhimit të komunitetit në veprimtarinë e tyre.

Asgjë nga përmbajtja e këtij parimi nuk duhet nënkuptuar se organizatat anëtare të CiviKos-it nuk mund të kompensojnë anëtarët e stafit apo vullnetarët për punën dhe shpenzime të caktuara, as se vullnetarët mund të shfrytëzohen përtej kufizimeve ligjore të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

### **Mosdiskriminimi**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it, në raportet e tyre reciproke me njëri tjetrin, Platformën CiviKos dhe palët e treta, angazhohen dhe do të respektojnë parimet bazë kundër diskriminimit.

Organizatrat anëtare nuk mund të diskriminojnë asnjë person apo grup personash mbi bazën e moshës, racës, kombësisë apo etnisë, përkatësisë fetare, gjinisë, edukimit, statusit financiar, social apo tjetër, orientimit seksual apo aftësisë së kufizuar.

### **Parandalimi i ngacmimit seksual**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it angazhohen për të respektuar parimet bazë që e parandalojnë ngacmimin seksual, si dhe do të hartojnë dhe zbatojnë politika të shkruara për të adresuar veprimet e tilla.

### **Gjithëpërfshirja**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it angazhohen që punën e tyre t'a bazojnë, për aq sa është e mundur, në gjithëpërfshirje të një grupi sa më të madh të njerëzve, anëtarëve, përfituesve dhe grupeve të prekura dhe jo vetëm të një grupi të vogël të njerëzve brenda organizatës respektive.

Platforma CiviKos, në veprimtarinë e saj, respekton dhe siguron zbatimin e parimit të gjithëpërfshirjes së anëtarëve të Platformës, në hartimin, zbatimin, vlerësimin dhe rishikimin e programeve, strategjive, politikave dhe dokumenteve tjera të platformës.

## **Transparenca**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it respektojnë parimin e transparencës në raportet e tyre reciproke me njëra tjetrën, në raportet me platformën dhe në raportet me palë të treta.

Platforma CiviKos respekton dhe promovon transparencën në raportet e saj me anëtarët e platformës, në raportet mes anëtarëve me njëri tjetrin, dhe në raportet mes anëtarëve dhe platformës me palë të treta.

## **Transparenca dhe Llogaridhënia financiare nga organizatat anëtare**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it i përmbahen parimeve më të larta të transparencës dhe llogaridhënies financiare, duke siguruar se zbatojnë legjislacionin e aplikueshëm për menaxhim financiar, të hartojnë dhe zbatojnë politika financiare të shkruara, të përgatisin rregullisht dhe të publikojnë pasqyrat e brendshme financiare, si dhe të krijojnë mekanizma të brendshëm që do t'i mundësojë anëtarëve të organizatës të raportojnë në mënyrë anonime për keqpërdorimet e mundshme financiare brenda organizatës.

Organizatrat anëtare të CiviKos-it të cilat kanë menaxhuar me buxhet vjetor mbi **100,000 Euro** ndërmarrin auditim të jashtëm financiar.

CiviKos angazhon ekspertë financiar për të zhvilluar një vlerësim të menaxhimit financiar të organizatave ose ndihmë për përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore financiare për organizatat anëtare me buxhet vjetor nën **100,000 Euro**, varësisht nga nevoja e shprehur dhe mjetet në dispozicion.

## **Transparenca dhe llogaridhënia financiare e CiviKos-it**

CiviKos i përmbat parimeve më të larta të transparencës dhe llogaridhënies financiare, duke siguruar se zbatojnë legjislacionin e aplikueshëm për menaxhim financiar, të hartojnë dhe zbatojnë politika financiare të shkruara, të përgatisin rregullisht dhe të publikojnë pasqyrat e brendshme financiare, si dhe të krijojnë mekanizma të brendshëm që do t'i mundësojë anëtarëve të organizatës të raportojnë në mënyrë anonime për keqpërdorimet e mundshme financiare brenda organizatës.

Në rast se CiviKos ka menaxhuar me buxhet vjetor mbi **50,000 Euro**, ndërmerr auditim të jashtëm financiar.

## **Ngritja e fondeve**

Organizatrat anëtare të CiviKos-it dhe CiviKosi janë të pavarura në ngritjen e fondeve për qëllimet e tyre legjitime në përmbushje të misionëve të tyre.



Organizatat anëtare dhe CiviKos fondet apo donacionet i pranojnë ekskluzivisht dhe vetëm me qëllim të mbulimit të aktiviteteve në përmbushje të misionit, duke përjashtuar çfarëdo financimi që i komprometon parimet themelore të punës dhe i kufizon aftësitë e veprimit dhe shprehjes së lirë. Gjithashtu, organizatat anëtare dhe CiviKos nuk bëhen pjesë dhe i kundërshtojnë të gjitha veprimet joetike që përfshijnë financim të dyfishtë të të njëjtit projekt, alokim fondesh jashtë qëllimeve të caktuara me projektin dhe mbiparaqitje të të arriturave gjatë një projekti.

Platforma CiviKos do të ketë kujdes të shtuar që gjatë ngritjes së fondeve për nevojat e veta operacionale, të mos dëmtojë mundësitë e organizatave anëtare për ngritje të fondeve nga të njejtat burime.

### **Qasja në Informata dhe dokumente të brendshme të CiviKos**

Organizatat anëtare të CiviKos-it kanë të drejtë të qasjes së plotë në dokumente të brendshme të organizatës për atë që kjo nuk ndalohet me akte të tjera të CiviKos-it dhe apo me vendim të Kuvendit të Anëtarëve.

### **Ruajtja e Privatësisë dhe Konfidencialitetit**

Organizatat anëtare të CiviKos-it obligohen të ruajnë privatësinë dhe konfidencialitetin e dokumenteve apo informatave të marra si pjesë e CiviKos-it, sa herë që një gjë e tillë kërkohet specifikisht nga dërguesi i informatës, si dhe të mos shpërndajnë dokumentet e ndjeshme apo të rëndësishme tek palë të treta pa aprovimin paraprak me shkrim nga ana e CiviKos-it.

### **Përfaqësimi dhe Prezantimi në Emër të CiviKos-it**

Organizatat anëtare të CiviKos-it, përderisa nuk autorizohen ndryshe, nuk mund të përfaqësojnë, flasin në emër të, apo të prezantohen si përfaqësues të CiviKos-it në marrëdhënie me njëra tjetrën dhe në marrëdhënie me palë të treta.

### **Burimet Njerëzore të organizatave anëtare**

Organizatat anëtare të CiviKos-it respektojnë ligjin e aplikueshëm të punës në Kosovë, parimet e parapara me këtë Kod, si dhe dokumentet tjera relevante të brendshme në marrëdhëniet e tyre me stafin, vullnetarët dhe të angazhuarit tjerë të organizatave tjera anëtare të CiviKos-it.

Organizatat anëtare të platformës do t'i njoftojnë anëtarët e stafit të tyre me përmbajtjen dhe obligimet që dalin nga ky Kod.

### **Burimet njerëzore të CiviKos**

CiviKos respekton ligjin e aplikueshëm të punës në Kosovë, parimet e parapara me këtë Kod, si dhe dokumentet tjera relevante të brendshme në marrëdhëniet e tyre me stafin, vullnetarët dhe të angazhuarit tjerë të platformës.

CiviKos do t'i njoftojnë anëtarët e stafit të platformës me përmbajtjen dhe obligimet që dalin nga ky Kod për atë sa dispozitat e këtij kodi janë poashtu të vlefshme për stafin e CiviKos-it.

### **Konflikti i Interesit**

Organizatave anëtare të CiviKos-it i vendosin qëllimet dhe interesat a platformës dhe interesat e shoqërisë civile në përgjithësi para interesit individual të një apo më shumë organizatave gjatë marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me punën dhe misionin e Platformës CiviKos.

Përfaqësuesit e organizatave anëtare të CiviKos-it, gjatë vendimmarrjes në Bord, Kuvend të Anëtarëve apo ndonjë procedure tjetër vendimmarrëse, nuk marrin pjesë në marrjen e vendimeve për çështjet në të cilat ajo ose ai ka interes personal ose ekonomik, apo anëtari i familjes së saj ose tij kanë interes personal ose ekonomik, apo organizata që ai ose ajo e përfaqëson kanë interes personal ose ekonomik.

### **Dhuratat**

Organizatave anëtare të CiviKos-it dhe platforma i kushtojnë kujdes të veçantë pranimit të dhuratave nga organizatat anëtare dhe jo anëtare dhe nga palët e treta, në atë mënyrë që kjo të mos ndikojë në pavarësinë operacionale dhe vendimmarrjen brenda dhe në raport me platformën CiviKos.

### **Partneriteti dhe Rrjetëzimi**

Organizatave anëtarë në bashkëpunimin e tyre me organizatat e tjera anëtare, Civikos-in dhe palë të treta i përkushtohen parimeve profesionale dhe etike të punës së përbashkët, si dhe bazohen mbi parimet e mirëkuptimit dhe respektimit të mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme që mund të kenë organizatat. Në raste të qëndrimeve të ndryshme rreth një çështjeje të caktuar, organizatat anëtare nuk dëmtojnë njëra tjetrën, por angazhohen në gjetjen e formave konsensuale të veprimit, në pajtim me misionet e tyre dhe të Platformës Civikos.

### **Ruajtja e ambientit dhe promovimi i përgjegjësisë ambientale**

Organizatave anëtare të CiviKos-it janë të përkushtuara që gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre në drejtim të përmbushjes së misionit të CiviKos-it t'i kushtojnë kujdes maksimal ruajtjes së ambientit dhe të promovojnë përgjegjësinë ambientale tek të tjerët.

## **Përgjegjësia Sociale**

Organizatave anëtare të CiviKos i kushtojnë kujdes të veçantë dhe promovojnë përgjegjësinë sociale që ato kanë ndaj komuniteteve apo shoqërive ku veprojnë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre, duke siguruar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut tek grupet e synuara, grupet shoqërore, komunitetin, apo shoqërinë në të cilët organizatat anëtare veprojnë gjatë planifikimit, zhvillimit apo pas zhvillimit të aktiviteteve të organizatave; mos shkaktimin e ndonjë dëmi të pariparueshëm tek një grup i caktuar shoqëror, komunitet, apo shoqëri; respektimin dhe mos cenimin e identitetit kulturor, shoqëror apo tjetër të një grupi të caktuar shoqëror, komuniteti apo shoqërie.

## **Obligimet pozitive të anëtarëve për zbatimin e Kodit Etik**

Organizatave anëtare dhe CiviKos-i kanë obligim parimor për të ndërmarrë hapa afirmativ që mundësojnë ruajtjen e integritetit të këtij Kodi në kuadër të punës dhe veprimtarisë së secilës organizatë anëtare apo CiviKos-it.

## **Vlerësimi Vjetor**

Me qëllim të ngritjes së kuptimit dhe kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e këtij Kodi, Sekretariati i CiviKos bën një vlerësim vjetor të përmbushjes dhe realizimit të obligimeve që dalin nga ky kod të organizatave anëtare.

Vlerësimi vjetor bëhet mbi bazën e një deklaratë vjetore të cilën secila organizatë anëtare e nënshkruan në mirëbesim çdo vit, duke konfirmuar se organizata përkatëse është duke respektuar të gjitha obligimet që dalin nga ky Kod, arsyet për mos-zbatimin e plotë të obligimeve si dhe sfidat dhe vështirësitë e hasura gjatë përpjekjeve për zbatim të obligimeve.

## **Amandamentimi**

Kuvendi i CiviKos, në cilëndo kohë mund të bëjë amandamentimin e këtij kodi përmes një vendimi për të cilin kanë votuar 2/3 e anëtarëve prezentë dhe që votojnë.

## **Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi një ditë pas aprovimit nga Kuvendi i anëtarëve.